

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Nisma e qeverisë për strehimin social, Pipiria: Është për tu përshëndetur! Ja zonat më të lira në Tiranë – Vizion Plus
ADRESA	https://www.vizionplus.tv/nisma-e-qeverise-per-strehimin-social-pipirija-eshte-per-tu-pe-rshendetur-ja-zonat-me-te-lira-ne-tirane/
BURIMI	vizionplus.tv
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	11 shtator 2026, 18:49:13 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	11 shtator 2026, 18:48:36 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	65f4dc8c8f6e0147a31fc784f2e5a6cc4466f96187c1ea440de3233f3bf75f7b
TEKSTI	f376ac8a6d68b8f5747db017e521f0a1b78b32a88788cb9e6941c1a063f8d01b
PAMJA	cf60b9c5016ac6cfebaeb23769ae1657dfa862871606f2df734ef0f31cb4f28c

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	6bd279f0d486157041ce9d63dd2b5baae37e536efac950017e502decad12a977
E MËPARSHMJA	6e0447bbe404a5919a80a9575c1eba0118eaa3f40079537fa16ea9f713d347c0
RRËNJA MERKLE	7f30966000672975708e7c492689d739f9d4667f12adc4270686e28ed502fc27
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahase hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/6bd279f0d486157041ce9d63dd2b5baae37e536efac950017e502decad12a977>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



çifteve të reja dhe profesionistëve, me kredi me zero interes për shuma deri në 60 mijë euro.

Lidhur me këtë nismë të qeverisë, në një lidhje me Edicionin Qendror të Lajmeve të orës 19:00 në Vizion Plus, të moderuar nga Pranvera Borakaj, Drejtori Ekzekutiv i Shoqatës së Pasurive të Paluajtshme, Reinaldo Pipiria, sqaroi se si mund të funksionojë.

I pyetur nga moderatorja Borakaj nëse ka ende banesa që shiten me 60 mijë euro në Tiranë, Pipiria tha se ka në periferi, por bëhet fjalë për banesa me sipërfaqe të vogla.

Sipas tij, nisma e qeverisë nuk bëhet fjalë vetëm për Tiranën, por edhe për qytete të tjera të vendit, ku çmimet janë më të ulëta.

Pjesë nga intervista:

Borakaj: Së pari, si e konsideroni këtë nisëm të prezantuar nga qeveria për Strehimin Social?

Renaldo Pipiria: Në fakt mendoj që është për t'u përshëndetur për shkak se jo më larg se vitin e kaluar ne kemi qarkulluar një dokument, një pozicion përse i përket zgjidhjes së strehimit social në të gjithë Bashkimin European për shkak se ne jemi pjesë e rrjetit european të shoqatave të pasurive të paluejtëshme dhe kemi paraprirë pak a shumë situatën që do të vinte në Shqipëri. Është një problem që nuk është vetëm në Shqipëri, është në gjithë Europën dhe mendoj që është gjëja më e mirë që të paktën të shprehim në këtë mënyrë që në Shqipëri të fillojmë dhe të marrim seriozisht

5 Eibasani nuk tan Egnatia peson humbjen e parë të sezonit

NEWSLETTER

Përmbledhja e ditës në e-mail

Abonohu

te arrijmë në këtë pikë që ne shqiptarët mendojmë dhe të merremi seriozisht me strehimin me përballueshmërinë dhe me pjesën tjetër që është pjesa e strehimit social.

Borakaj: Qeveria në fakt ka hartuar edhe më herët programe. Mendoni se këtë radhë do t'i japë zgjidhje problematikave të strehimit për çiftet e reja dhe kategoritë në nevojë?

Renaldo Pipiria: Mendoj që është fillim i duhur dhe i mbarë. Patjetër që ka më tepër hapa që duhen ndërmarrë. Pse e them këtë gjë? Sepse ne kemi parë vetëm pjesën e kërkesës. Pra me subvencionimin e qerasë, me subvencionimin e interesave të kredisë apo qoftë edhe kreditë që janë me normë zero, është duke u fuqizuar akoma më tepër kërkesa. Mendoj që ashtu si në gjithë Europën dhe Shqipërinë për arsye totalisht diametritikisht të ndryshme ofertat në të dyja dhe në Europë e Shqipëri janë të ngurtësuar. Kështu që mendoj që duhet të arrijmë në një pikë që të merr me çështjen e ofertës. Pra sot nuk është se nuk kemi kërkesë, por për shkak se oferta është e ngurtësuar, kërkesa nuk arrin dot ta përballoj çmimet që vendosin, që vendos krahu i shitësit, këtu besoj që ka nevojë për ndërhyrje dhe ka nevojë për pak më tepër shpejtësi në ndërmarrjen e disa politikave fiskale që mund të çlirojnë ofertën, që të mund të dekurajojnë spekulimin dhe që të mund të inkurajojnë përfshirjen e pronarëve të pasurve të paluejtshme, ata që kanë mundësi në programet e strehimit, pra që të vendosin pronat e tyre në programet e strehimit dhe mos mbyllur apo mos e çojnë në alternativa të tjera.

Borakaj: Një nga një nga gjashtë shtyllat e programit është ajo e banesave me kosto të ulët me subvencion nga shteti për kreditë e marrë. Është parashikuar të përfitojnë gati 4 mijë çifte të reja dhe profesionistë. Po ku gjenden këto banesa me kosto kaq të ulët në Tiranë? Ka ende banesa me 60 mijë euro në kryeqytet?

Renaldo Pipiria: Çmimi mesatar në Tiranë është 2000-2100 euro për m². Pra nuk mund të them ka apo nuk ka. Në të njëjtën kohë zonat më të lira në Tiranë është zona e Freskut, e Kombinatit, zona e QTU-së edhe e Paskuqanit që është 1100 deri në 1300 euro m².

Pra me 60 mijë euro mund të mund të gjeshe një studio apo garsionere ose 1+1 55 m² mesatarisht. Kështu që nuk po them që është e pamundur, por është shumë e vështirë. Në të njëjtën kohë besoj që nuk bëhet fjalë vetëm për Tiranën dhe këtu isha duke folur për Tiranën. Mendoj në rrethe çmimet që janë totalisht ndryshe, madje ka rrethe të cilët i kanë shumë më të lira sesa Tirana, por kthehemi prapë në pikën zero ku jemi duke thënë vërtetë kemi disa masa, kemi para që duam të hedhim në krahun e ofertës, më falni, në krahun e kërkesës, por duhet të sigurohemi që oferta po i përgjigjet.

Prandaj sugjeroj shumë që në muajt në vijim, teksa plani do duhet të fillojë të bëhet, po themi të të dal për konsultim publik dhe në pas 2027 bëhet realitet, të mund të punojmë me ofertën, sepse këto 7 mijë banesa thotë, pra 2 mijë me kredi zero 2 mijë me kredi për subvencionim të interesit deri në 3% edhe 3 mijë të tjerë i thonë për subvencionimin e qerasë është presion i ftuar mbi kërkesën mbi tregun që tregu do të jetë i përgjigjet po kur ka zero inkurajim që pronat mos rrinë mbyllur por të dalin në treg për shkak të një taksimi mbi të ardhur të vijë nga qera 15% një tatimi mbi fitimin kapital përveç periudhës së rivlerësimit në 1 janar 2017 e në vijim kushdo që do ta tregtoj pasurinë e vet do duhet të paguaj 15% edhe pse mund të jetë pjesë e programit të strehimit.

Pra ka disa anomali fiskale që e bëjnë pronarin që do ta shesi pronën apo ta fusi pjesë e programit të ngurtësohet dhe të mos marri përsipër që të bëhet pjesë e programit por të vendosi të vazhdojë ta mbajë pronën e vet të mbyllur. Në të njëjtën kohë duhet të marrim në konsideratë që edhe iniciativat apo dekurajimet që duhet të vijnë nëpërmjet politikës fiskale përsa i përket taksave mbi pasuritë e paluajtëshme janë janë totalisht të shlyera për 2029-ën dhe 2031-i. Kështu që meraku që sot është këto 7 mijë çelësa që duhet të gjejnë derën për të hapur në 2027-ënn do të ofrojnë presion mbi tregun nëse nuk merremi me krahun e ofertës dhe krahun i ofertës është totalisht në dorë të ekzekutivit përsa i përket politikës fiskale që të çlirojnë një pjesë të mirë të ofertës apo të pronave të pa të pashfrytëzuara rregullisht në në Shqipëri.

#Nisma #pipirija #qeveria #social #strehimi #VizionPlus



Taulant Halili

Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.

Të gjithë artikujt

Vazhdo të lexosh

EKONOMI

Kërkohet më shumë kredi për shtëpi,...

Xhuljana Zhuleku · Dje 17:01

EKONOMI

U kallëzua në SPAK, ministri i Financave...

Redaksia Web · 10 Sht

EKONOMI

Financimi i Grave Sipërmarrëse,...

Taulant Halili · 8 Sht



Vizion Plus është një nga televizionet kryesore kombëtare në Shqipëri — lajme, programe, seriale dhe sport, drejtpërdrejt dhe on demand, 24 orë në ditë, kudo që je.

LIVE



Lajme

Politikë
Bota
Vendi
Kronikë
Lifestyle

Programe

Programe
Seriale
Guida TV
Video
Ekipi i Vizion Plus

Rrjeti

Rreth nesh
Karriera
Kontakt
Reklamo me ne
Dërgo lajmin tënd

Ligjore

Kushtet e përdorimit
Privatësia
Cookies
Politika editoriale

© 2026 Vizion Plus · Të gjitha të drejtat e rezervuara

vizionplus.tv

Kthehu lart ↑

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.